

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“BLERJE INTERNET-INTRANET, MARRËVESHJE KUADËR, ME NJË OPERATOR  
EKONOMIK KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA - ME AFAT PËR 4  
VITE”,**

**Fondi limit në total:119,990,720** (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH

**Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro.

**Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e larte monetar”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 64221000-1,  
Shërbime të interkoneksionit;**

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), nenit 76.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

**b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;**  
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

**AFATI I DORËZIMIT TE MALLIT: do të jetë për 48 (dyzetë e tetë) muaj kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës.**

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jetë në lote sipas arsyetimit të mëposhtëm:**

Ne zbatim të Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 të LPP, Njësia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen në Lote të procedurës së prokurimit për shërbimin e internetit për arsye se kjo procedure është e pamundur teknikisht të ndahet në kontrata të ndryshme. Realizimi i këtij shërbimit do të kontrollohet dhe monitorohet nga “Posta Shqiptare” sh.a. Autoriteti Kontraktor ka vendosur të zhvillojë këtë procedure pa ndarë në lote për shkak se synon të përfitojë shërbimin në një kohë sa më të shpejtë, pa vonesa me qëllim garantimin e mbarevajtjes së punës dhe plotësimit të kërkesave të përditshme të punës. Duke qenë se kemi të bëjmë me një shërbim me shtrirje të gjere teritoriale, autoriteti kërkon të finalizojë nënshkrimin e një kontrate me një operator, cka do të sillte edhe menaxhimin sa më të thjeshtë dhe më të shpejtë të kontratës dhe rrjedhimisht edhe përfitim të shërbimit brenda afateve të kërkuara, pa vonesa dhe pa burokraci.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,(i ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (ndryshuar) autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Referuar pikës 1 të Shtojcës 10, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 99% e vlerës së fondit limit.

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në pikën 2/a të Nenit 43 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika2/a: ***2.Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;***

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara më poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore,** është bërë bazuar në Nenin 43 të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të furnizimeve/shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara/ shërbimeve të realizuara.  
ose
- b) në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara/shërbimeve të realizuara.

**Shënim:** *Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues te kete realizuar me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK krijon sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit (‘DPA’) ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) Standardin **ISO 9001:2015** ose ekuivalente (e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë.

b) Standardin **ISO 27001:2022** ose ekuivalente (e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

c) Standardin **ISO 20000-1:2018** ose ekuivalente (e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ofertues në këtë procedurë, secili prej operatoreve ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata “ISO” të rënditura më lart, sipas zërave të shërbimeve/mallrave, që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt marrëveshjes midis palëve.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”( i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- c) *Certifikimi ISO 9001:2015 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.*
- d) *Certifikimi ISO 27001:2013 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë, të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesit të këto sisteme të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do të ketë vijim të mirëmbajtjes dhe garancisë së suportit të të dy sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike, për aq sa ekspozohen sistemet në fjalë.*
- e) *Certifikimi ISO 20001-1:2018 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të dy sistemet që kërkohen në DST, të cilët janë tërësisht të bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se është i regjistruar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve nëntokësore të komunikimeve elektronike në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përmendura në listën e pikave të shërbimit të DST. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur duke paraqitur Vërtetimin për prezencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuara nga AKEP, të cilat dëshmojnë praninë e rrjetit nëntokësor të Operatorit Ekonomik në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përcaktuara në listën përkatëse. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ofertues në këtë procedurë, duhet që secili prej tyre të dorëzojë Vërtetimin për ekzistencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (‘AKEP’), në përputhje me zërat e shërbimeve/mallrave që ai do të realizojë, bazuar në

*marrëveshjen e lidhur midis palëve. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).*

**Argumentimi:***Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Fibrat optike janë forma më e shpejtë e internetit (bazuar dhe në specifikimet teknike ku shpejtësia e transmetimit është 1Gb/s) dhe transferimit të të dhënave aktualisht në dispozicion dhe duke qënë në kushtet që shërbimi i internetit kërkohet të jetë lidhje me fibër optike, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se zotëron një infrastrukturë të vetën me fibër optike që të përmbushë nevojat e Autoritetit Kontraktor në venddodhjen e tij. Në kushtet kur Operatori Ekonomik nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike pranë vendodhjes së Autoritetit Kontraktor, apo filialeve dhe degëve të Autoriteti Kontraktor, pranon paraqitjen e një kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP-i duke përmbushur kushtet e Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një propozim e zgjidhjes teknike të zbatimit për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, i cili përfshin një përshkrim të detajuar dhe skemat përkatëse të rrjetit për çdo pikë, si dhe një strategji rezerve (back-up) për garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimit.

Kërkesa për plotësimin e kapacitetit të pikës **2.3.4** do të konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik do të paraqesë propozimin teknik për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, duke përfshirë përshkrimet dhe skemat e rrjetit të ofruesit për secilën pikë, planin e back-up për vazhdimësinë e shërbimit.

**Argumentimi:***(Kriteri i vendosur garanton autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Operatori ekonomik duhet të ofrojë për autoritetin kontraktor besim, siguri dhe garanci për cilësinë e shërbimit objekt prokurimi, shërbimi i Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a sic kerkohet ne Shtojcen 5 - Specifikimet teknike. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi-layer DDoS protection, në të gjithë perimetrat e sigurisë (lokale, kombetare dhe nderkombetare). Gjithashtu për platformen e përdorur për ofrimin shërbimit DDoS, operatori ekonomik duhet ta provojë duke

paraqitur kontraten e blerjes/suportit te platformes respektive per mbrojtjen DdoS (me nje kompani/ofrues sherbimi per te cilen duhet te paraqitet autorizim rishitje apo prodhuesi).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik per kete sherbim, kontrates se blerjes/suportit te platformes respektive si edhe autorizimin si rishites/prodhues per kompanine me te cilen operatori ka marreveshje per kete sherbim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 41, pika 4 paragrafi ç) dhe pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Në kushtet aktuale, ku siguria kibernetike ka marrë një rëndësi të veçantë, ofrimi i specializuar i shërbimit DDoS është shume i rendesishem për ofrimin e shërbimeve të Postes Shqiptare. Për më tepër disa shërbime të ofruara nga Posta Shqiptare. janë listuar si shërbime kritike për sigurinë kombëtare. Kriteri i mësipërm garanton mbrojtjen profesionale dhe automatike nga sulmet DDoS.

Duke marrë parasysh rritjen e kërcënimeve kibernetike ndaj rrjeteve të institucioneve publike dhe organizatave me infrastrukturë kritike, operatori ekonomik ka detyrimin te paraqese një zgjidhje të strukturuar dhe të dokumentuar për sigurinë e rrjetit, duke përfshirë mjetet e mbrojtjes ndaj sulmeve, firewall të avancuar dhe sisteme të monitorimit të vazhdueshëm, si edhe mbrojtja qe do te ofrohet te jete ne disa nivele sigurie dhe teresisht automatike duke demonstruar përgatitjen dhe aftësinë për të garantuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e të dhënave të Autoritetit Kontraktor. Propozimi i detajuar teknik, i mbështetur me skema dhe dokumenta provues eshte domosdoshmëri për të garantuar një shërbim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të besueshëm për një periudhë afatgjatë.

**2.3.6** Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të çertifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a. 3 (tre) punonjes të çertifikuar të rrjetit Cisco (CCNA) ose ekuivalente.
- b. 2 (dy) inxhinierë të çertifikuar në arkitekturë dhe dizajn rrjeti SCTE ose ekuivalente.
- c. 2 (dy) teknike te certifikuar ne nivel teknik SCTE ose ekuivalente.
- d. 2 (dy) punonjes të çertifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).
- e. 2 (dy) inxhinierë të çertifikuar në siguri rrjeti.
- f. 1 (një) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.
- g. 1 (nje) punonjës i çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.

**Shënim:** Një punonjës mund të ketë një ose më shumë çertifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.
- Çertifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër. 9

**Argumentimi:** Diplomat universitare për punonjësit e specifikuar në përputhje me pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit garantojnë se stafi teknik dhe inxhinierik i operatorit ka përgatitjen akademike të duhur për të implementuar dhe mirëmbajtur shërbimin e internetit/intranetit në të gjitha filialet dhe zyrat postare. Së dyti, çertifikatat dhe dëshmitë e vlefshme nga organe të akredituara, dhe jo nga site online të paakredituara, janë të domosdoshme për të siguruar njohuri të specializuara dhe të verifikuara të stafit në fushën e rrjeteve dhe komunikimeve elektronike. Operatorët ekonomikë që ofrojnë shërbime kritike të tilla si interneti/intraneti duhet të disponojnë personel të çertifikuar nga institucione të njohura, të cilat sigurojnë që kualifikimi i tyre është në përputhje me standarde të njohura ndërkombëtare dhe me rregulloret në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Kjo eliminon rrezikun e përfshirjes së stafit të pakualifikuar, që mund të ndikojë negativisht në cilësinë, sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit. Së fundmi, listëpagesat eSig25 për tre muajt e fundit janë thelbësore për të vërtetuar që stafi i deklaruar është realisht pjesë e operatorit ekonomik. Kjo kërkesë parandalon praktikën e angazhimit fiktiv të specialistëve vetëm për qëllimet e tenderit dhe siguron që operatori ka kapacitetin real për të ofruar shërbimin, duke demonstruar se punonjësit janë të regjistruar dhe të punësuar në mënyrë legjitime, sipas legjislacionit në fuqi. Në një marrëveshje kuadër 4-vjeçare, është jetike që stafi të jetë i disponueshëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, duke siguruar vazhdimësi operationale dhe mirëmbajtje të shërbimit në standardet e kërkuara.

**Shënim:** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentat e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i çertifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmarrë, apo realizojnë sipas marrëveshjes.

Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi a), b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektivit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

**a. 3 (tre) punonjes të certifikuar të rrjetit Cisco (CCNA) ose ekuivalente.**

**Argumentimi: Germa A)** Së pari, rrjetet e Internet/Intranet që do të përdoren në filialet dhe zyrat postare kërkojnë një konfigurim të saktë dhe të sigurt për të garantuar lidhje të qëndrueshme dhe të besueshme. Çertifikimet si CCNA ose ekuivalente, i dëshmojnë AK se specialistët kanë njohuri të avancuara në protokollet e rrjetit, konfigurimin e pajisjeve, menaxhimin e adresave IP dhe sigurinë e të dhënave, duke siguruar një funksionim optimal të rrjetit pa ndërprerje apo probleme teknike. Së dyti, duke qenë se marrëveshja ka një kohëzgjatje prej 4 vitesh, është e domosdoshme të ketë një ekip të dedikuar specialistësh të aftë për mirëmbajtjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së rrjetit. Rrjetet që përfshijnë shumë filiale dhe zyra postare kanë nevojë të ndryshme për konfigurime të personalizuar, si dhe kërkojnë monitorim dhe ndërhyrje të shpejtë në rast të problemeve teknike. Një ekip prej 3 specialistësh të certifikuar siguron që çdo problem të trajtohet shpejt dhe efikasiteti i rrjetit të ruhet në çdo kohë. Së treti, siguria kibernetike është një faktor kyç për rrjetet e shpërndara që lidhen me zyrat postare dhe filialet. Specialistët e certifikuar në CCNA ose ekuivalente kanë njohuri mbi masat e sigurisë, si konfigurimi i firewall-eve, VLAN-ve dhe enkriptimi i të dhënave, duke reduktuar ndjeshëm rreziqet e sulmeve kibernetike dhe rrjedhjeve të të dhënave. Me një ekip të dedikuar specialistësh, rrjeti mund të mbrohet nga kërcënimet e jashtme, duke siguruar ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave që qarkullojnë në sistem. Së fundi, prania e pesë specialistëve të certifikuar garanton që operatori ekonomik ka kapacitetet teknike dhe njerëzore të nevojshme për të përmbushur kërkesat e shërbimit në një shtrirje të gjerë gjeografike. Zyrat postare dhe filialet janë të shpërndara në zona të ndryshme të Shqipërisë, dhe nevojë për një ekip të kualifikuar siguron që problemet të trajtohen në mënyrë të decentralizuar, duke shmangur vonesat dhe ndërprerjet e shërbimit. Për më tepër, në rast se një ose disa specialistë janë të angazhuar në një problematikë specifike, prania e një ekipi të përbërë nga 3 ekspertë lejon një shpërndarje efektive të detyrave dhe një mbulim të vazhdueshëm të rrjetit.

**b. 2 (dy) inxhinieri të certifikuar në arkitekturë dhe dizajn rrjeti SCTE ose ekuivalente.**

**Argumentimi : Gërma B)** Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij dy specialistë të certifikuar në arkitekturë dhe dizajn rrjeti, është një domosdoshmëri për garantimin e një rrjeti të qëndrueshëm, të sigurt dhe të optimizuar për nevojat e Autoritetit Kontraktor. Duke qenë se Posta Shqiptare operon me një shtrirje të gjerë gjeografike, duke përfshirë zyra dhe filiale në zona urbane dhe rurale, rrjeti i komunikimit duhet të jetë i projektuar në mënyrë që të sigurojë lidhje të pandërprerë, siguri të lartë dhe efikasitet operativ. Specialistët e certifikuar në arkitekturë dhe dizajn rrjeti janë të nevojshëm për të hartuar, zbatuar dhe mirëmbajtur një strukturë rrjeti që përmbush standardet teknike të kërkuara, duke siguruar një shpërndarje të barabartë të trafikut, menaxhim të ngarkesës. Për më tepër, për shkak të natyrës kritike të shërbimeve të Postës Shqiptare, çdo ndërprerje apo problem teknik mund të shkaktojë ndërprerje të komunikimit dhe të dëmtojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve, prandaj është thelbësore që të ketë ekspertë të kualifikuar që mund të parandalojnë dhe adresojnë çdo problem teknik në kohë reale. Duke qenë se prokurimi është një marrëveshje kuadër për 4 vite, specialistët e certifikuar janë të domosdoshëm për të siguruar që rrjeti do të evoluojë dhe përshtatet me teknologjitë e reja, duke mbajtur nivelin e kërkuar të performancës dhe sigurisë për të gjithë filialet dhe zyrat postare të Postës Shqiptare.

SCTE është një organizatë certifikuese e themeluar në vitin 1945, me qendër në Watford, Britani e Madhe dhe ofron një sërë kursesh dhe trajnimesh për profesionistë në fushën e telekomunikacionit kabllor. SCTE (certifikim në nivel teknik) ofron trajnime si teknik të instalimit, teknik të shërbimit, teknik të rrjetit etj. Gjithashtu njihet ndërkombëtarisht si një nga pesë organet certifikuese më të mira në fushën e teknologjisë së informacionit. Çertifikatat SCTE kanë një bazë të gjerë të njohurive të ndërtimit të rrjetave, njohuri të teknologjisë Wifi, si dhe bazohen në testimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave të teknologjive të ndryshme si Fibra, Koaksial etj.

**c. 2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente.**

**Argumentimi : Gërma C)** Në zbatim të dispozitave ligjore të sipërpërmendura, kriteri i vendosur për të paktën 2 (dy) teknik të certifikuar SCTE (certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente është në përputhje dhe përplotësim me objektin dhe volumin e kontratës së prokurimit, bazuar kjo në domosdoshmërinë e vijueshmërisë së shërbimeve 24/7 ditë të javës si dhe në shpërndarjen gjeografike të konsiderueshme të vendndodhjeve ku do të ofrohet ky shërbim, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke ditur se, sic është cituar edhe më lart:

SCTE është një organizatë certifikuese e themeluar në vitin 1945, me qendër në Watford, Britani e Madhe dhe ofron një sërë kursesh dhe trajnimesh për profesionistë në fushën e telekomunikacionit kabllor. SCTE (certifikim në nivel teknik) ofron trajnime si teknik të instalimit, teknik të shërbimit, teknik të rrjetit etj. Gjithashtu njihet ndërkombëtarisht si një nga pesë organet certifikuese më të mira në fushën e teknologjisë së informacionit. Çertifikatat SCTE kanë një bazë të gjerë të njohurive të ndërtimit të rrjetave, njohuri të teknologjisë Wifi, si dhe bazohen në testimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave të teknologjive të ndryshme si Fibra, Koaksial etj.

Kërkesa për të paktën 2 (dy) teknik të certifikuar SCTE (certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente është e nevojshme dhe e domosdoshme për realizimin e lidhjeve të Fibrave Optike, të konfigurimeve të nevojshme si dhe për të garantuar mirëmbajtjen e shërbimit përgjatë periudhës së kërkuar në përmbushje të SLA, objekt kontrate.

Kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës. Niveli i kërkuar teknik garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike për realizimin e shërbimeve të kërkuara.

**d. 2 (dy) punonjës të certifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).**

**Argumentimi : Gërma D)** Kërkesa për të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për siguri kibernetike është një kërkesë e domosdoshme e cila i provon autoritetit se Operatori Ekonomik ka në përbërjen e tij staf të kualifikuar në implementimin e metodave për të siguruar rrjetin nga sulmet e mundshme kibernetike, konkretisht (por nuk kufizohet në) me zërat:

-Rrjeti duhet të jetë i sigurtë, i mbrojtur dhe me parametra teknikë që të sigurojnë shërbime për transmetime multimediale data, voice video.

-Për IP-ne publike të kërkuar, do të realizohet mbrojtje ndaj sulmeve DDoS.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë kritike që ka ky shërbim për Autoritetin, niveli i sigurisë duhet të jetë i lartë për të parandaluar sulme të mundshme, aksesë të pa autorizuara në rrjetin e Postës Shqiptare, dhe për më tepër ndërprerjen e shërbimeve si pasojë e sulmeve kibernetike.

Referuar sa më sipër kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka në stafin e tij inxhinier të certifikuar për siguri kibernetike për të përmbushur shërbimet e kërkuara objekt kontrate.

***e. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në siguri rrjeti.***

**Argumentimi : Gërma E)** Kërkesa për dy inxhinierë të certifikuar në siguri është e domosdoshme për të garantuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e rrjetit të komunikimit në një mjedis ku përpunohen të dhëna sensitive dhe kritike për shërbimet publike. Posta Shqiptare operon me infrastrukturë të shpërndarë, duke përfshirë një rrjet të gjerë filialesh dhe zyrash postare në të gjithë vendin, ku transmetohen të dhëna të ndjeshme të përdoruesve, përfshirë transaksione financiare, të dhëna personale dhe informacione institucionale. Për këtë arsye, prania e dy inxhinierëve të certifikuar në siguri siguron që masat e sigurisë kibernetike janë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare dhe rregulloret në fuqi, duke mbrojtur rrjetin nga kërcënime si sulmet kibernetike, ndërhyrjet e paautorizuara, rrjedhja e të dhënave dhe shkeljet e privatësisë.

Duke qenë se kjo është një marrëveshje kuadër për 4 vite, është thelbësore që siguria të jetë e vazhdueshme dhe proaktive, duke përfshirë monitorimin, analizimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse gjatë gjithë periudhës së kontratës. Dy inxhinierët e certifikuar do të jenë përgjegjës për projektimin, konfigurimin dhe menaxhimin e politikave të sigurisë së rrjetit, si dhe për parandalimin dhe përgjigjen ndaj incidenteve të sigurisë, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve apo komprometimit të të dhënave. Gjithashtu, ata do të luajnë një rol kyç në përafrimin e rrjetit me standardet e sigurisë si ISO 27001, duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes për informacionin e ndjeshëm që qarkullon në sistemet e Postës Shqiptare. Në një kontekst ku kërcënimet në rrjet po evoluojnë vazhdimisht dhe rreziku i sulmeve është në rritje, pranimi i operatorëve ekonomikë që disponojnë dy inxhinierë të certifikuar në sigurinë e rrjetit garanton që rrjeti i Postës Shqiptare do të mbetet i mbrojtur, i qëndrueshëm dhe i besueshëm për të gjitha filialet dhe zyrat postare në të gjithë vendin.

***f. 1 (një) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.***

**Argumentimi : Gërma F)** Realizimi I objektit të kontratës konsiston në ofrimin e instalimit të lidhjeve, konfigurimeve, operacioneve, si edhe menaxhimin e të gjithë procesit tekniko-administrativ.

Për këtë arsye kjo procedurë vlerësohet si një projekt i cili përfshin ndër të tjera: Planifikimin, implementimin, operimin, menaxhimin e burimeve njerezore, menaxhimin e afateve kohore si edhe garantimin e ofrimit të shërbimit në të gjithë teresinë e tij sipas termave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Të gjitha sa janë cilesuar më lart i perkasin një personi të certifikuar në menaxhimin e projekteve, për ta vertetuar këtë kapacitet dhe për të garantuar seriozitetin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, institucioni ka kërkuar që stafi që menaxhon këto procese të jetë i certifikuar.

Mungesa e nje personi te certifikuar ne menaxhimin e projekteve mund te sjelle mangesi te renda ne implementimin dhe mbarevajtjen e procesit te levrimit te sherbimit dhe mund te shkoje deri ne deshtim ne realizimin e kontrates.

Gjithashtu vlen te theksohet qe ky sherbim I perket fushes se telekomunikacionit, ku perditesimi I stafit me certifikimet e nevojshme eshte nje domosdoshmeri dhe jo zgjedhje e operatoreve ekonomike.

***g. 1 (nje) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.***

**Arqumentimi : Gërma G)** Kërkesa për nje punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente në kuadër të prokurimit me objekt “Blerje Internet-Intranet për filialet dhe zyrat postare të Postës Shqiptare”, i siguron AK një menaxhim të qëndrueshëm, të organizuar dhe efikas të shërbimeve IT nga ana e operatorit ekonomik. Duke qenë se ky prokurim mbulon një rrjet të gjerë të zyrave postare dhe filialeve në të gjithë vendin, kërkohet një strukturë e fuqishme menaxheriale dhe teknike për mbikëqyrjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit. Certifikimi ITIL (Information Technology Infrastructure Library) është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e shërbimeve IT, i cili siguron një qasje të strukturuar në trajtimin e problemeve teknike, përmirësimin e performancës dhe ofrimin e një shërbimi cilësor dhe të qëndrueshëm ndaj përdoruesve. OE duke dëshmuar prezencën e te pakten nje punonjësi të certifikuar, sigurohet që menaxhimi i shërbimeve të rrjetit të Internet/Intranet do të kryhet në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke përmirësuar efikasitetin operativ dhe duke reduktuar rrezikun e ndërprerjeve apo dështimeve të sistemit. Një rrjet kaq i madh dhe kritik, si ai i Postës Shqiptare, kërkon monitorim dhe optimizim të vazhdueshëm, për të garantuar cilësi të lartë të shërbimit, disponueshmëri të lartë dhe adresimin e problemeve me një qasje të standardizuar dhe të shpejtë. Nje ekspert ITIL ben ndarjen e përgjegjësiive në monitorimin, incident management, problem management dhe service improvement, duke siguruar menaxhim efektiv të infrastrukturës, planifikim strategjik të kapacitetit dhe burimeve, si dhe një përgjigje të shpejtë ndaj emergjencave teknike. Standardi ITIL ose ekuivalent ndihmon në standardizimin e protokolleve të shërbimit, duke siguruar që çdo ndërhyrje, mirëmbajtje apo përmirësim të kryhet në mënyrë të planifikuar dhe me impakt minimal në veprimtaritë e përditshme. Për më tepër, me një marrëveshje kuadër 4-vjeçare, është thelbësore që të ketë një strukturë të mirëorganizuar për të monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht performancën e rrjetit, duke mundësuar një shërbim të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

---

***Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga strukturë e posacme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.***

***Shenim:*** Të gjitha dokumentet të cilat janë për tu paraqitur nga operatorët ekonomik dhe janë të përfshira në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të Shtojca 10, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura nëse deklarohen në këtë formularë sikurse kërkohet dhe në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues (ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë) që të dorëzojë dokumentet provuese për

*vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

**Njësia e Prokurimit:**